24.4 Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

24.5 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 24.2 kontraktori mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

### **Neni 25 Paramasa dhe Paralogaria**

25.1 Paramasa dhe paralogaria duhet të përmbajnë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve që duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe paralogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Paralogarisë për çdo artikull.

25.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përmbajë aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktiviteteve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregojë shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

#### **Neni 26 Parapagimi**

26.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shuma e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shuma që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

26.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmojë se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

26.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

#### **Neni 27 Mbajtja e Parasë**

27.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim të tërë të Punëve. Kjo shumë në asnjë rast nuk do të tejkalojë 10% e vlerës totale të kontratës origjinale. Kontraktuesi mund të zëvendësojë paratë e mbajtura me garancion bankar “me kërkesë”.

27.2 Shuma e mbajtur ose garancia e mbajtjes do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29.

#### **Neni 28 Vërtetimet e pagesës**

28.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

28.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

28.3 Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

28.4 Vlera e punës së përfunduar përfshin:

- a. Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Paralogarisë, vlerën e sasisë së punës në Paramasë dhe Paralogari që është përfunduar; ose
- b. Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëjë vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

28.5 Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

#### **Neni 29 Llogaritja përfundimtare**

29.1 Kontraktuesi jo më vonë se 90 ditë pas lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit, do të dorëzojë tek Menaxheri i Projektit një draft të deklaratës së llogarisë përfundimtare me dokumentet mbështetëse që tregojnë në

detaje vlerën e punës së bërë në përputhje me kontratën, së bashku me të gjitha shumat e mëtejshme të cilën Kontraktuesi konsideron se duhet paguar sipas kontratës, në mënyrë që Menaxheri i Projektit të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare.

29.2 Brenda 30 ditëve pas pranimit të draft-deklaratës se llogarisë përfundimtare dhe të gjithë informacionit të kërkuar në mënyrë të arsyeshme për verifikimin e saj, Menaxheri i Projektit do të përgatisë deklaratën e llogarisë përfundimtare, e cila përcakton:

- a) Shumen e cila sipas opinionit të tij duhet të paguhet sipas kontratës; dhe
- b) pas evidentimit të shumave të paguara paraprakisht nga Autoriteti Kontraktues dhe i të gjitha shumave të cilat i takojnë Autoritetit Kontraktues sipas kontratës, bilanci, nëse ka, nga Autoriteti Kontraktues tek Kontraktuesi, ose nga Kontraktuesi tek Autoriteti Kontraktues, siç mund të jete rasti.

29.3 Menaxheri i Projektit do të lëshojë te autoriteti kontraktues ose te përfaqësuesi i tij i autorizuar, dhe te Kontraktuesi, deklaratën e llogarisë përfundimtare që paraqet shumen përfundimtare për të cilën duhet paguar Kontraktuesi në bazë të kontratës. Autoriteti kontraktues ose përfaqësuesi i tij i autorizuar dhe Kontraktuesi duhet të nënshkruajnë deklaratën e llogarisë përfundimtare, si një njohje e vlerës së plotë dhe përfundimtar të punës së realizuar sipas kontratës dhe menjëherë do të dorëzojë një kopje të nënshkruar të Menaxherin e Projektit.

### **Neni 30 Shkaqet për kompensim**

30.1 Shkaqet për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

- (a) Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK.
- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesa tjera për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

### **PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFEKTET**

#### **Neni 31 Parimet e përgjithshme**

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

#### **Neni 32 Testet për përfundimin**

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara ne shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët te cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

### **Neni 33 Pranimi i përkohshëm**

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe te jete lëshuar, ose konsiderohet te jete lëshuar, një **certifikatë e pranimit të përkohshëm**.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, te jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

### **Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet**

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe te cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të filloj nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

### **Neni 35 Pranimi përfundimtar**

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të pranimit përfundimtar**, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe te jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të porealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

### **Shkelja e kontratës dhe shkëputja**

#### **Neni 36 Shkelja e kontratës**

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

#### **Neni 37 Shkëputja e kontratës**

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- (a) Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- (b) Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- (c) Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- (d) Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- (e) Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;

(f) Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e Punëve për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur cilado nga palët kontraktuese njofton Menaxherin e Projektit për shkelje të kontratës për arsye të tjera nga ato të renditura më lart nën 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë a është shkelja thelbësore apo jo.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesit do të përfundoj vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

### **Neni 38 Forca madhore**

38.1 “Force Madhore” siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisive të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.

ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.

iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.

iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.

v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

### **Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një çertifikatë mbi vlerën e punës së përfunduar dhe materialet e porositura me më pak se përqindja e cila kërkohet nga vlera e punëve të përfunduara, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve.



#### **Neni 40 Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

#### **Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

#### **Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

#### **Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

30.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

## KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë, Gjuha Shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është <i>10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 25 muajve</i>
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda [5] ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë: 19.09.2024
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 19.09.2026
Regjistri i punës	20.1	Për punët e përfunduara, nevoitet regjistri
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit caktohet sipas vendimit të ZKA-së
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periodha garantuese e defekteve është 1 vjeqare
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit se kësaj kontrate dhe se është e mundur të zgjidhet në mënyrë miqësore, përgjegjës për zgjidhjen e tyre do të jenë personat përgjegjës të Autoritetit Kontraktues – KOMUNA E PRISHTINES, të zyrtareve përgjegjës të Autoriteteve Kontraktuese që shfrytëzojnë kontratën dhe personat përgjegjës të OE
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve kompetente për kontestin eventual atëherë është <b>Gjykata Komerciale - në Prishtinë</b>

## Rregullimi i oborreve dhe rrethojave te tereneve sportive

### PARAMASA DHE PARALLOGARIA

Kushte te pergjithshme:

Pershkrimi i punëve. Ne perputhshmeri te pjota me standartet EC dhe ISO.

Paramasat dhe parallogaria eshte e dhuna detalisur ne pershkrimin teknik, dhe i nenshtrohet pershkrimin teknik.

Masat e sigurise: Duhet te jene ne nivolin me te larte per arsye te ruajtjes se shendetit te personave qe punojne dhe jetojne atje punishtes. Pra ne keto matjre duhet te behet rrethimi sa me i mte i punishtes dhe vendosjes e materialeve ne te si dhe te mirren masat e nevojshme te sigurtes (preveniva) hapshore ne mes te zones nen ndertim (RENOVIM) dhe zoneve te tjera te cikat mbeten ne stifiksim gjate fazes se punimeve. Materialet nuk duhet te dalin jashte rrethojes se punishtes.  
Punishja te rrethohet me tabela prej llamame dhe me konstrukcion te perforcuar mire ne toke. Para fillimit te punimeve punekryesi duhet qe ne kosto te parashteh edhe blidqjen e instalimeve eksistuese ne fillim te ekzekutimit te punimeve si dhe rikudqjen e instalimeve pas realizimit te punimeve si dhe punimet dhe masat e nevojshme per konzervimin te instalimeve egzistuese te cikat ngjelen ne sheshin (funksioni) gjate dhe pas realizimit te punimeve.

Per secilin pozicion ku jane përmendur karakteristikat teknike te prodhuesit mund te perdoren materialet me karakteristika te ngjajshme te prodhuesve te ndryshem ne perputhje me standartet EC dhe ISO.

VEREJTJE: Te gjitha materialet e perdorura dhe te ekzekutuara duhet te deshmohen me atejte

NR.	PERSHKRIMI I POZICIONIT	NYESIA	SASIA	ÇMIMI	ÇMIMI I PESHUAR	PESHA (%)
1	Demolimi i fushes sportive eksistuese. Pozicioni përfshinë demolimin e shtresës së pllakës beton arme (asfalt beton) eksistuese si dhe germimin e shtresës së dheut deri ne nivelin e caktuar me projekt. Pozicioni përfshinë edhe transportin e materialit të tepërt deri në depori në përputhje me normalivat ndërtimore	m <sup>2</sup>	1	15.00€	9.00€	
2	Demolimi i konstrukcionit te betoneve te mureve dhe coklave nga beton armeja me dimensione te ndryshme, shtkalive te ndryshme nga beton armeja dhe transporti dhe largimi i tyre deri ne depori.	m <sup>2</sup>	1	10.00€	6.00€	
3	Demolimi i rrethojave eksistuese nga konstrukcioni metalik te fushave dhe demolimi i rjetave te vjetra. Pozicioni përfshinë edhe transportin e materialit të tepërt deri në depori në përputhje me normalivat ndërtimore. Llogaria ne meter gjatesi, lartesia e rrethojes deri 5 metra.	m	1	10.00€	6.00€	

4	Demolimi i shkallëve anësore për të krijuar hapësirë në të gjerë për qasje. Demolimi është komplet i betonit të shkallëve dhe muri atëri për zgjerim. Llogaritja për m <sup>2</sup> të demohuar, në llogaritje hyn edhe transporti i materialit në depopin e caktuar nga organet kompetente.	m <sup>2</sup>	1	12.00€	7.20 €
5	Demolimi i rampave, pjesa mbrenda mureve për të kriju rampat sipas projektit, në këtë demolin hynë edhe muret anësore aq sa është e nevojshme që të përshat muri me rampën e re si dhe të krijohet mundësi vazhdimi në pjesë të caktuara. Llogaritja për m <sup>2</sup> të demohuar. Në llogaritje hynë të parapara të përshihen edhe kubizat e rampave e edhe betoni. Në llogaritje hynë edhe transporti i materialit të demohuar në depopin e caktuar nga organet kompetente.	m <sup>2</sup>	1	10.00€	6.00 €
6	Demolimi i kubezave në tratuare dhe sheshet ku ka lëvizje. Llogaritja për m <sup>2</sup> të demohuara. Kubizat e demohuara të deponohen në një depo të caktuar nga organet kompetente komunale.	m <sup>2</sup>	1	10.00€	6.00 €
7	Demolimi i anësoreve të kubezave të të gjitha llojeve për të kriju nivelin e kërkuar me projekt të kubezave. Në llogaritje hyn komplet demolimi edhe me betonin i cili është përdorur për shtratat të kubezave. Anësoret e demohuara të deponohen në depopin e caktuar nga organet kompetente. Llogaritja për m <sup>2</sup> gjatësi të demohuar.	m <sup>1</sup>	1	10.00€	6.00 €
8	Punimi i mbushjes së sipërfaqeve për realizimin dhe zgjerimin e niveleve të gëlbrimit si në pjertesi ashtu edhe në sipërfaqet e trashëtsia, me sasi nga gërmimi (me dheun cilësor) dhe me huazim. Në llogaritje hynë edhe ngjeshja e teranit në trashësi sipas gjendjes në teren.	m <sup>2</sup>	1	18.00€	10.80 €
9	Punimet e kallupimit, furnizimi dhe sjellja e betonit C 25/30, hudhja e betonit në pozicion, betonimi, mjetëmbajtja e betonit dhe largimi i kallupimeve për punimin e pllakës beton arme me trashësi 15 cm.	m <sup>2</sup>	1	45.00€	27.00 €
10	Furnizimi me material dhe sanimi i fushës ekzistuese nga betoni C-25/30, duke përgadit si baze për vendosjen e shtresës finale të fushës (teranti duhet të trashëtohet mire dhe të jetë stabil), mjetëmbajtja e betonit dhe largimi i kallupimeve (trashësia mesatare e betonit të etimuar për sanimin dhe trashësinë e pllakës është 10 cm.	m <sup>2</sup>	1	35.00€	21.00 €
11	Punimi i mureve tërthore ndaj kaskadave kryesore, në pjesën e denivelimeve në pjesët anësore të shkallëve nga konstruksioni i betonarmesë C-30/37 me dimensione sipas Projektit. Në çmim të llogaritjet komplet betoni për mur dhe thembrale. Llogaritja për sasinë e egzekutuar në vend.	m <sup>2</sup>	1	180.00€	108.00 €

12	Furnizimi dhe betonimi i tokuarve per trati terreneve sportive sipas kerkesave me beton me trashesi 15 cm si dhe vendosja e armatures rreth Q 335 15/15 cm	m <sup>2</sup>	1	60.00€	36.00 €
13	Furnizimi dhe punimi i mureve betonarme ne pjeset e ngritura te rampave per invalida (mbujlla anesore). Betoni te jete C30/37 i armuar me rreze Ø8/5x15 cm ne dy zona. Llogjeron per m <sup>2</sup> te punuar bashke me themel.	m <sup>2</sup>	1	210.00€	126.00 €
14	Betonimi dhe armimi i shkalleve te ndryshme me C-30/37 dhe hekur Ø 12/15 cm ne pozicionet e paraqitura ne projekt me dimenzione perkatese.	m <sup>3</sup>	1	215.00€	129.00 €
15	Betonimi i mureve te betonit me lartesi te ulet hmes=100 cm dhe me armim te lehte rreze armature Ø 10/15, dhe C-30/37. Dimenzionet sipas Projektit Per Krijimin e Nivelit te kerkuat te rampave.	m <sup>3</sup>	1	230.00€	138.00 €
16	Furnizimi me material dhe sarimi i fushes ekzistuese me bituagregat Bit 22. Ne POS te perfshihen gjerzija e asfaltit ekzistues, dhe asfaltimi i shteses se re, transportimi dhe deponimi i asfaltit te gjerzyer ne depoti legale rrin. ne largesi 5km. Sarimi i gropave ekzistuese. Lyezja me emulsion e shteses se gjerzyer. Trashesia mesatare 15 cm.	m <sup>2</sup>	1	55.00€	33.00 €
17	Furnizimi, transporti, perpunimi i Bituagregatit Bit 22 me trashesi me trashesi T=7cm ne gjendje te ngjeshur	m <sup>2</sup>	1	37.00€	22.20 €
18	Furnizimi, transporti, perpunimi i asfaltbetonit AB11 d=4cm ne gjendje te ngjeshur.	m <sup>2</sup>	1	25.00€	15.00 €
19	Furnizimi me material dhe punimi i shyllave te metalit forme D 100x60x4 mm me gatesi 200 cm. Shyllat vendosen ne cdo 2m aksiale njera nga jetra. Ne ctrim duhet llogaritur edhe ngjyrosjen , fillimisht me ngjyre minium (dy shtresa) dhe ngjyre yndyrore (dy shtresa).	cope	1	66.00€	39.60 €
20	Furnizimi me material dhe punimi i shyllave te metalit forme D 80x80x4 mm me gatesi 200 cm. Shyllat vendosen ne cdo 2m aksiale njera nga jetra. Ne ctrim duhet llogaritur edhe ngjyrosjen , fillimisht me ngjyre minium (dy shtresa) dhe ngjyre yndyrore (dy shtresa).	cope	1	35.00€	21.00 €
21	Furnizimi me material dhe punimi i shyllave te metalit forme D 60x60x4 mm me gatesi 200 cm. Shyllat vendosen ne cdo 2m aksiale njera nga jetra. Ne ctrim duhet llogaritur edhe ngjyrosjen , fillimisht me ngjyre minium (dy shtresa) dhe ngjyre yndyrore (dy shtresa).	cope	1	25.00€	15.00 €
22	Furnizimi me material dhe punimi i bazamentit te shyllave nga betoni i armua C25 me dim (40x50x60) cm. Ne ctrim duhet llogaritur edhe armaturen Ø8 dhe Ø10 per armim te themellit dhe shtresa e zhanavorit me trashesi t=20 cm e ngjeshur.	cope	1	45.00€	27.00 €


23	Furnizimi, punimi dhe montimi elementeve te gardhit rrethues metalik me h = 1.50 m konstruksioni nga profilet e çelikut – vertikalet me profile 20x20x2 mm të vendosur në çdo 14 cm. Lidhja e vertikaleve me shpyllat kryesore bëhet me dy horizontale 60x40x3 mm si ne detalin e dhënë . Ne çmim duhet llogaritur edhe ngjyrosjen , fillimisht me ngjyrë minimum -antikorodues (dy shtresa) dhe ngjyrë yndyrore (dy shtresa) Të gjitha punimet të ekzekutohen sipas detajit dhe nen mbikëqyjen dhe aprovimin e menaxherit të projektit-kontratës.	m'	1	155.00€	93.00 €
24	Furnizimi, punimi dhe montimi elementeve te gardhit rrethues metalik me h = 2.0 m konstruksioni nga profilet e çelikut – vertikalet me profile 40x20x2 mm të vendosur në çdo 14 cm. Lidhja e vertikaleve me shpyllat kryesore bëhet me dy horizontale 80x40x3 mm si ne detalin e dhënë . Ne çmim duhet llogaritur edhe ngjyrosjen , fillimisht me ngjyrë minimum -antikorodues (dy shtresa) dhe ngjyrë yndyrore (dy shtresa) Të gjitha punimet të ekzekutohen sipas detajit dhe nen mbikëqyjen dhe aprovimin e menaxherit të projektit-kontratës.	m'	1	175.00€	105.00 €
25	Furnizimi dhe punimi i dyerve te hyrjes me dimension 5.50x1.50 m të pajisura komplet me lëshese, bagllama, dorëz dhe çelës. Ne çmim duhet llogaritur edhe ngjyrosjen , fillimisht me ngjyrë minimum -antikorodues (dy shtresa) dhe ngjyrë yndyrore (dy shtresa) Të gjitha punimet të ekzekutohen sipas standardeve per kete pune , nen mbikëqyjen dhe aprovimin e menaxherit të projektit-kontratës.	çope	1	630.00€	378.00 €
26	Furnizimi dhe punimi i dyerve te hyrjes me dimension 6.50x2.0 m të pajisura komplet me lëshese, bagllama, dorëz dhe çelës. Ne çmim duhet llogaritur edhe ngjyrosjen , fillimisht me ngjyrë minimum -antikorodues (dy shtresa) dhe ngjyrë yndyrore (dy shtresa) Të gjitha punimet të ekzekutohen sipas standardeve per kete pune , nen mbikëqyjen dhe aprovimin e menaxherit të projektit-kontratës.	çope	1	750.00€	450.00 €
27	Furnizimi dhe punimi i dyerve te hyrjes me dimension 1.0x2.0 m të pajisura komplet me lëshese, bagllama, dorëz dhe çelës. Ne çmim duhet llogaritur edhe ngjyrosjen , fillimisht me ngjyrë minimum -antikorodues (dy shtresa) dhe ngjyrë yndyrore (dy shtresa) Të gjitha punimet të ekzekutohen sipas standardeve per kete pune , nen mbikëqyjen dhe aprovimin e menaxherit të projektit-kontratës.	çope	1	200.00€	120.00 €
28	Furnizimi dhe punimi i rrethojës së rrempave për invalid me profile Ø 63 mm përkatëse sipas skicave në projekt h=90 cm.Siliko skloen.Llogarita për meter gjatësi të punuar.	m'	1	65.00€	39.00 €

29	<p>Hapia e gropave të shlyllave me dim. 50x50x100cm, në cdo tri metra, duke llogaritur edhe transportimin e dheut në depoti.</p> <p>Furnizimi dhe punimi i bazamentit të shlyllave nga betoni i armuar C25, dhe me dimensione 50 x 50 x 80cm, të vendosura në distancë aksiale ~300cm, në grimë duhet të llogaritet edhe shtesa e tamponit nën bazament me trashësi t=20cm i ngjeshur nga fraksioni 0-60. Para betonimit vendoset ankeret për shlyllat kryesore prej profileve të çelikut me dimensione 80mm x 80mm (me trashësi të profilit 4mm), me lartësi 800 mm të lyer me pare me dy shtesa ngjyrë antikorotive. Detaili rrethoja 1 Në cmim llogaritet edhe armature e nevojshme për themelin si në detalin e dhene</p>	cope	1	60.00€	36.00 €
